

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

**01.05.2021
Ora 11:47**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetë deklarues, zotin Artur Ismail Baku, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor Partia Socialiste për Integrim, Qarku Durrës”.

PJESËMARRJA :

KQZ

- | | |
|--|-----------------------------|
| 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z.Illirjan Celibashi |
| 2. Stafi KQZ: | Y.Merkaj, M.Koja |
| 3. Parti Politike: | LSI, PDIU |

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë kalojmë tek pika e dytë e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetë deklarues, zotin Artur Ismail Baku, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor Partia Socialiste për Integrim, Qarku Durrës. Për këtë kandidat dhe për kandidatët e tjerë për të cilët kemi shqyrtimin sot, si fillim, ka ndonjë që është prezent? Po, nuk është prezent askush. Kemi informacion nëse kanë marrë apo jo dijeni?!

Z. Y. Merkaj: Po kemi komunikuar mbrëmë me të katër subjektet deklaruese. Kanë marrë dijeni, Zef Hila ka kthyer përgjigje se do të jetë prezent në këtë seancë megjithatë nuk është këtu në sallë.

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

Z. I. Celibashi: Po subjektet e tjerë, rezulton që janë njoftuar a kemi dijeni ?

Z. Y. Merkaj: Kanë dhënë miratimin që do të bëhet në mungesë!

Z. I. Celibashi: Mirë, vazhdojmë atëherë!

Z. Y. Merkaj: Në zbatim të ligjit 138 të vitit 2015, për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtronjë funksione publike, KQZ është organi kompetent për administrimin, verifikimin dhe zbatimin e ndalimeve për zgjedhjet dhe emërimin e funksionarëve si dhe përpunimin e formularëve të subjekteve ndër të tjerë dhe kandidatët për deputet nga Organet Qeverisjes Vendore. Në zbatim të ligjit të mësipërm, zoti Artur Ismail Baku si kandidat i listës shumëmemërore të subjektit politik Partia LSI ka depozituar në KQZ formularin e vetdeklarimit me numër unik 5549. Pas verifikimit të të dhënave në formularin e vetdeklarimit, rezulton se nuk ka të dhëna të sakta të bëjë me ndalime të ligjit nr.138 të vitit 2015, si dhe nga përgjigjet të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ku rezulton se nuk ka të regjistruara dënime penale të formës prerë në sistem. I është propozuar KQZ-së i cili me vendimin nr 147 datë 16.03.2021 ka miratuar listën shumëmemërore të kandidatëve për deputet të Partisë LSI për të 12 qarqet në zonën zgjedhore. Referuar përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ku deklarohet se zoti Artur Ismail Baku nuk ka të dhëna në sistem por, subjekti vetëdeklarues deklaroi se në formularin e deklarimit se ka një vendim gjyqësor jo të formës së prerë. KQZ i është drejtuar Prokurisë të Përgjithshme për të kaluar rastin për verifikim të thelluar. Në përgjigje Prokuroria e Përgjithshme referon se pas kryerjes të gjitha

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

verifikimeve të mundshme brenda vendit rezulton se verifikimi është kryer i plotë, i gjithanshëm dhe konstatohet se subjekti vetdeklarues nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit numër 138, të vitit 2015. Për sa më sipër referuar konkluzionit të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se për subjektin vetëdeklarues Artur Ismail Baku kandidat për deputet i Partisë LSI Qarku Durrës, nuk ka të dhëna që subjekti të përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit numër 138, të vitit 2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrohen në funksione publike. Në këto kushte, i propozojmë Komisionerit të shpall me vendim që nuk përfshihet në kushtet e ndalimit kandidati për deputet, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Përfaqësues të partive politike? Dakord! Mirë atëherë bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës të Shqipërisë si dhe ligjit numër 138, të vitit 2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, si dhe pika 12 kreu 5, i vendimit numër 17 të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë vendos:


1.Konstatimin se zoti Artur Ismail Baku, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor Partia LSI, Qarku Durrës, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit, të parashikuar nga ligji numër 138 të vitit 2015, për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

2.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 ditëve nga nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ.

Vendimi nr. 328

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

01.05.2021
Ora 11:52

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z.Napolon Engjëll Laska, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor “Nisma Thurje”, Qarku Tiranë”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja

• **Parti Politike: LSI, PDIU**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Kandidati për deputet nga lista shumemërore i subjektit politik Nisma Thurje zoti Napolon Engjëll Laska, ka depozituar në KQZ formularin e deklarimit me numër unik 1251. Pas verifikimit të formularëve të deklarimit, rezulton se nuk të dhëna që kanë të bëjnë me ndalimin e ligjit numër 138 të vitit 2015. Gjithashtu dhe pas përgjigjes së ardhur dhe nga Drejtoria e Gjendjes Civile dhe nga Drejtoria e Burgjeve ku rezulton se ka kryer dënime penale në sistem. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin numër 155, datë 17.03.2021 ka miratuar listën shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Nisma Thurje, për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 për të 12 qarqet e Republikës së Shqipërisë. Referuar përgjigjes së Gjendjes së Përgjithshme të Burgjeve ku duke qenë se i referohet një vendimi gjyqësor për kandidatin për



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

deputet zotin Napolon Laska. Subjekti vetëdeklarues nuk ka deklarur asnjë detyrim të duke qenë se ka kontradita i është drejtuar KQZ, Prokurorisë të Përgjithshme për të kaluar rasti për verifikim të thelluar si institucioni kompetent për kryerjen e plotë të deklarimeve të bëra. Në përgjigje Prokuroria e Përgjithshme referon sipas kryerjes të gjithave verifikimeve të mundëshme brenda vendit rezulton se, verifikimi është kryer i plotë i gjithanshëm dhe konstatohet se subjekti deklarues nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit numër 138 të vitit 2015 “Për Garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”. Për sa më sipër referuar konkluzioneve të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se për subjektin deklarues Napolon Engjëll Laska nuk ka të dhëna që subjekti të përfshihet në kushtet e veprimit të nenit 2, të ligjit numër 138, të vitit 2015. Në këto kushte i propozoj Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të shprehet me vendim për konstatimin e këtij ndalimi.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësues të partive politike? Nuk kemi diskutime! Atëherë bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës të Shqipërisë si dhe ligjit numër 138 të vitit 2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike, si dhe pika 12 kreu 5 i vendimit të Kuvendit të Shqipërisë numër 17 të vitit 2016 vendos:

1.Konstatimin se zoti Napolon Engjëll Laska, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor Partia Nisma Thurje, Qarku Tiranë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit, të parashikuar nga ligji numër 138 të vitit 2015, për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

- 2.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr. 329



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

01.05.2021
Ora 11:55

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z.Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor “Lëvizja për Ndryshim”, Qarku Vlorë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**

• **Parti Politike:** **LSI, PDIU**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Kandidati për deputet i listës shumëemërore nga subjekti politik Lëvizja për Ndryshim, Qarku Vlorë, zoti Adrian Vullnet Gjoka ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit me numër unik 3001. Pas verifikimit të formularëve të deklarimit, konstatohet se nuk ka asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me ndalimin e ligjit numër 138 të viti 2015. Gjithashtu dhe pas përgjigjes së ardhur dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe nga Drejtoria e Burgjeve ku rezulton se nuk ka regjistruar dënime penale të formës së prerë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin numër 158 datë 17.03.2021 ka vendour të miratojë listën shumëemërore të kandidatëve për deputetë të Partisë Lëvizja për

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

Ndryshim, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 për të 12 qarqet e Republikës së Shqipërisë. Referuar përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ku deklarohet se zoti Adrian Vullnet Gjoka, nuk ka të dhëna në sistem, por subjekti vetëdeklarues, ka deklaruar në formularin e deklarimit se ka një vendim gjyqësor, jo të formës së prerë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur ta kalojë rastin për hetim të thelluar, në Prokurorinë e Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme pas verifikimit rezulton se, pas kryerjes së të gjitha verifikimeve të mundshme brenda vendit, rezulton se verifikimi është kryer i plotë, i gjithanshëm dhe konstatohet se subjekti deklarues Ardian Vullnet Gjoka nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit nr.138, të vitit 2015. Për sa më sipër, referuar konkluzionit të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se për subjektin deklarues, zotin Adrian Vullnet Gjoka, nuk ka të dhëna që subjekti të përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit nr.138, të vitit 2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partive politike? Nuk kemi! Mirë, atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit nr.138/2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike si dhe pikës 12, të kreut 5, të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, nr.17, 2016 vendos:

Konstatimin se zoti Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor, Partia Lëvizja për Ndryshim, Qarku Vlorë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr.138, datë 2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr. 330

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

01.05.2021
Ora 11:40

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e tabelës së rezultateve të votimit në zonën zgjedhore të Qarkut Kukës, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

KQZ

- 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi**
- 2. Staf i KQZ: Y.Merkaj, M.Koja**
- 3. Parti Politike: LSI, PDIU**

Z. I. Celibashi: Mirëmëngjesi të gjithëve, atëherë në seancën publike të ditës së sotme kemi në rend dite për të shqyrtuar: Projekt vendimin për miratimin e tabelës së rezultateve të votimit për zonën zgjedhore të qarkut Kukës, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021; Pastaj kemi projektvendimin për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetë deklarues, zotin Artur Ismail Baku, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor Partia Socialiste për Integrim, Qarku Durrës; projektvendimin për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetë deklarues, zotin Napolon Engjell Laska, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor “Nisma Thurje”, Qarku Tiranë. Projektvendimin për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetë deklarues, zotin Zef Kim Hila, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Aleanca për

1

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

Ndryshim, Qarku Shkodër. Projektvendimin për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetë deklarues, zotin Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor Lëvizja për Ndryshim, Qarku Vlorë. Pika e gjashtë, projektvendim për plotësimin e vendit bosh në Këshillin e Bashkisë Kamëz, me kandidatin nga lista shumemërore, kandidatin e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Emigena Damzi. Pika e fundit, pika e shtatë, projektvendim për plotësimin e vendit bosh në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore, me kandidatin e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Gjin Ndreçë Kola. Këto pika janë në rendin e ditës, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës; me projekt vendimin që ka të bëjë me miratimin e tabelës së rezultateve të votimit për zonën zgjedhore të Qarkut Kukës, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

Z. Y. Merkaj: Atëherë në zbatim të nenit 123/1 të Kodit Zgjedhor, parashikohet që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për zonën zgjedhor për Kuvend, apo për njësinë e qeverisjen vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë zona të administrimit zgjedhor, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ të zonës zgjedhore përkatëse.

Për këtë, KQZ-ja plotëson tabelën përmbledhëse të rezultateve të zonës zgjedhore dhe e miraton atë me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbërritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore. Në datë 25 Prill 2021, në 12 zonat zgjedhore të Republikës së Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Zona zgjedhore e Qarkut Kukës ka në përbërje tre zona të administrimit zgjedhor, përkatësisht, Zonat Zgjedhore nr. 9, 10, dhe 11. Pas përfundimit të procesit dhe numërimit të votave dhe plotësimit dhe miratimit të tabelave me rezultatet



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

përmbledhëse për subjektet dhe për kandidatët për deputetë të këtyre njësive zonale, KZAZ-të nr. 9, 10, dhe 11, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë të këtyre subjekteve. Bazuar në tabelat përkatës për çdo qendër votimi dhe në tabelat përmbledhëse origjinale të kandidateve dhe të subjekteve zgjedhore.

Tabela përmbledhëse e rezultatit për subjektet zgjedhore përfshin rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të qendrave të votimit të tyre. Gjithashtu tabelat përmbledhëse të kandidatëve për deputetë për çdo zonë zgjedhore të KZAZ-ve të sipërcituara përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të qendrave të tyre të votimit. Në bazë të rezultateve përmbledhëse të zonave të mësipërme, rezultatet për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë, janë hartuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për zonën elektorale të Qarkut Kukës. Nga krahasimi i tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi me tabelat e rezultateve të ZAZ-ve përkatëse dhe rezultatet elektronike në sistem nuk u vërejtën mospërputhje të shifrave. Në këto kushte, i propozoj Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të miratojë tabelën përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhor të Qarkut Kukës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Nga përfaqësuesit e partive politike, diskutime?! Nuk kemi! Faleminderit!

Mirë, atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1 , shkronja “n”, dhe pika 2, si dhe neni 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendos:

Miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të zonës zgjedhore, Qarku Kukës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi. Miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore Qarku Kukës në zgjedhjet për



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, sipas materialeve bashkëlidhur këtij vendimi.

Po bëj me dije vetëm rezultatet për subjektet dhe disa të dhëna. Atëherë, sipas tabelës së miratuar numri i zgjedhësve që kanë votuar në këtë qark është 40894. Fletë votimi të pavlefshme janë 2188. Fletë votimi të vlefshme janë 38656. Fletët e votimit të vlefshme janë shpërndarë si vota të vlefshme për partitë, subjektet zgjedhore, si vijon: Partia Socialdemokrate 183 vota; Partia Balli Kombëtar 63 vota; Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare 56 vota; Partia Bindja Demokratike 51 vota; Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni Ora e Shpresës dhe Konservatorët 12 vota; Lëvizja Socialiste për Integrim 64 vota; Nisma Thurje 45 vota; Partia Lëvizja e Re 134 vota; Koalicioni Partia Demokratike dhe Aleanca për Ndryshim 24071 vota; Partia Demokracia e Re 47 vota; Partia Lëvizja për Ndryshim 74 vota dhe Partia Socialiste 13856 vota. Bashkëlidhur janë edhe tabelat edhe për numrin e votave që ka marrë secili prej kandidatëve në listën shumëemërore për secilin prej subjekteve zgjedhore.

Vendim nr.331

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

**01.05.2021
Ora 11:58**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidatin nga lista shumëemërore e PSSH, zoti Gjin Ndrec Kola”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:** **LSI, PDIU**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikat e tjera!

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Lezhë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari Eduard Ndue Ndreca, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor kandidati vijues nga lista shumëemërore e subjektit politik Partia Socialiste, të cilit i ka rënë mandati, është këshilltari me numër rendor 19, zoti Sandër Nik Mirashi. Kandidati për këshilltar ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, ku rezulton se nuk ka të dhëna për parashikim dhe për ndalim të ligjit nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku rezulton se nuk ka shënime në sistem për dënime penale. Referuar pikës 2, të kreut të pestë, të vendimit nr.17, të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit Bashkiak, Gjin Ndrec Kola në Këshillin e Bashkisë Lezhë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike, nuk kanë diskutim? Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe neni 11, të ligjit 138/2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, kreu i pestë të vendimit, të Kuvendit të Shqipërisë nr.17, 2016 vendos, zoti Gjin Ndrec Kola, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit. Pika e dytë: Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zoti Gjin Ndrec Kola. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendim nr. 332

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

**01.05.2021
Ora 12:01**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kamëz me kandidatin nga lista shumëëmërore e PSSH, zonja Emigena Xhetan Damzi”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:** **LSI, PDIU**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Kamëz ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari Egzon Isa Ymaj, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Referuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor kandidati vijues, të cilit i takon për të marrë mandatin e deputetit është kandidati me numër rendor 48, zonja Alketa Zybi Çela, e cila nuk ka depozituar formularin e vetëdeklarimit brenda afatit ligjor të përcaktuar në nen, që është 10 ditë. Kandidati vijues, të cilit i takon mandati, është kandidati me numër rendor 52, zonja Emigena Xhetan Damzi. Kandidati për këshilltar ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, ku nga verifikimi i formularit nuk rezulton të ketë të dhëna që kanë të bëjnë me parashikimet për ndalimin e ligjit nr.138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Gjendjes Civile, e cila nuk ka kthyer përgjigje. Ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.05.2021*

Gjendjes Gjyqësore ka sjellë verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin ku rezulton se nuk ka shënime në sistem për dënime penale. Referuar pikës 2, kreu 5, të vendimit nr.17, të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Kamëz, zonja Emigena Xhetan Damzi, nuk përbëjnë kusht për mospërzgjedhjen në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partive politike, nuk kemi diskutime! Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 e nenit 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, nenit 11 të ligjit nr.138/2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, kreu i pestë, të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, nr.17, 2016 për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimin e parashikuar në ligjin nr.138/2015 vendos, zonja Emigena Xhetan Damzi kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kamëz, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit, plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Kamëz me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Emigena Xhetan Damzi. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr. 333

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

